

Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

**Kërcënimi i Gjyqësorit: Siguria e Gjyqtarëve dhe
Prokurorëve**

Edicioni 3

Prill 2010

Kërcënimi i Gjyqësorit: Siguria e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është e brengosur se mungesa e sigurisë adekuate për gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkel ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjatë rrjedhës së monitorimit të sistemit të drejtësisë, OSBE-ja ka qenë dëshmitare dhe ka regjistruar një numër të veprimeve të kryera kundër zyrtarëve gjyqësorë dhe të prokurorisë, të cilat tregojnë një trend të vazhdueshëm, madje edhe në rritje të pasigurisë dhe kërcënimeve ndaj gjyqësorit. Kjo ndikon jo vetëm në pavarësinë dhe pa-anësinë e gjykatave, ose të paktën perceptimin e këtyre, por gjithashtu dëmton besueshmërinë dhe autoritetin e institucioneve gjyqësore dhe të prokurorisë në sytë e publikut. Gjetjet dhe analizat në këtë raport janë të bazuara në të dhënat më të fundit dhe informatat faktike të mbledhura nga monitoruesit e OSBE-së. Incidentet e monitoruara dhe të raportuara të kërcënimit ndaj gjyqësorit të paraqitura në këtë raport kanë ndodhur brenda objekteve të gjykatave, në zyrat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe/ose brenda sallave të gjyqësorit; gjatë dhe jashtë orarit të punës; dhe në të gjitha nivelet e gjykatave dhe të prokurorisë.

OSBE-ja ka raportuar më parë mbi çështjen e sigurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.¹ Problemi i sigurisë është ngritur gjithashtu rregullisht nga gjykatësit dhe prokurorët gjatë tryezave të rrumbullakëta të mbajtura nga OSBE.² Monitoruesit e OSBE-së kanë raportuar për incidentet e lidhura me sigurinë kundër gjyqtarëve, prokurorëve madje edhe personelit ndihmës, duke filluar nga fyerjet verbale, ngacmimet dhe kërcënimet deri në rrahje të rënda dhe lëndime trupore.

Autoritetet kanë një obligim afirmativ që të sigurojnë se të drejtat e garantuara sipas Konventës Evropiane për të Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNj) janë praktike dhe efektive, dhe jo teorike e iluzioniste.³ KEDNj garanton të drejtën për një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj.”⁴ Në jurisprudencën që përshkruan themelet e kësaj të drejte, (GjEDNj) ka theksuar se “[...] gjyqtarët nuk duhet vetëm të përmbushin kriteret objektive të paanësisë por duhet edhe të shihen që janë të paanshëm, se çfarë është çështja këtu është besimi me të cilin gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në ata që janë sjellë para tyre”.⁵ Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut (Komisioni)⁶

¹ Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale i OSBE-së “*Mbrojtja e Dëshmitarëve në Sistemin e Drejtësisë Penale*” (mars 2002-prill 2003), në faqe 12.

² Pas publikimit të raporteve mujore dhe/ose tematike mbi sistemin e drejtësisë, OSBE rregullisht mban tryeza të rrumbullakëta me gjyqtarë, prokurorë, policinë dhe akterët e tjerë relevant me qëllim që të diskutojë gjetjet e raporteve. Në vitin 2009, OSBE ka organizuar dhe ka mbajtur 16 tryeza të rrumbullakëta rajonale me gjyqtarë dhe prokurorë, në të cilat çështja e sigurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve është ngritur rregullisht.

³ Shih *Artico kundër Italisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 13 majit 1980, paragrafi 33.

⁴ Neni. 6 (1), KEDNj.

⁵ *Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj, Aktgjykimi i 25 shkurtit 1997, paragrafi 73; *Incal kundër Turqisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 9 qershorit 1998, paragrafi 65. GjEDNj më tej ka gjetur se “puna e gjykatave, të cilat janë garantuese të së drejtës dhe të cilat kanë rol thelbësor në [...] sundimin e ligjit, duhet të gëzojnë besimin e publikut. Andaj ato duhen të jenë të mbrojtura nga sulmet e pabazuara.” *Skalka kundër Polonisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 majit 2003, paragrafi 34. “Gjykatat, si edhe të gjitha institucionet tjera publike, nuk janë immune ndaj kritikave dhe hetimeve. Personat në paraburgim gëzojnë në këtë fushë të drejtat e njëjta si të gjithë anëtarët tjerë të shoqërisë. Megjithatë, duhet të bëhet një dallim i qartë ndërmjet kritikës dhe fyerjes. Nëse qëllimi i

ka deklaruar se në mënyrë që të vendoset nëse një organ gjyqësor mund të konsiderohet i pavarur, duhet të merren parasysh, *inter alia*, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe kohëzgjatja e pozitës, lidhur me ekzistimin e garancive kundër presioneve të jashtme, dhe pyetjes se a paraqet organi pamjen e pavarësisë.⁷ Komisioni gjithashtu ka deklaruar se është e parëndësishme nëse ndikimi nga burime të jashtme ose ndonjë anshmëri aktualisht ka ndodhur; çfarë është relevante në shqyrtimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës është se paraqitet duhet të merren parasysh.

Siç është cekur në Raportin e Raportuesit Special të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut⁸ "[...] Nuk është vetëm çështje e mbrojtjes së individëve të përfshirë në gjyqësor ose në aktivitet të ngjashëm; ka një kontekst institucional mbi çështjen: ndarja e pushteteve, demokracia dhe sundimi i ligjit. [K]onceptet e paanësisë dhe pavarësisë së gjyqësorit [që janë vulat e legjitimitetit të funksionit gjyqësor] vendosin attribute individuale si dhe gjendje institucionale ... Mungesa e tyre qon në mohim të drejtësisë dhe e bën të dyshimtë besueshmërinë e procesit gjyqësor. Duhet të theksohet se paanësia dhe pavarësia e gjyqësorit është më shumë e drejtë e njeriut e konsumatorëve të drejtësisë se sa privilegj i gjyqësorit për hir të vetes."⁹

Në vitin 1985, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, që nënvizon elementet fundamentale të gjyqësorit të pavarur. Këto përfshijnë kushtin që pavarësia e gjyqësorit të garantohet dhe [...] të ruhet në [...] [instrumentet legjislativ].¹⁰

Në mënyrë të ngjashme, korniza ligjore e Kosovës parasheh se "[gjyqtarët] duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në të gjitha rastet pa rënë nën ndikimin e faktorëve të jashtëm, dhe [ata duhet] të kryejnë detyrat gjyqësore në secilin rast duke u bazuar në fakte dhe në ligjet e aplikueshme pa kurrfarë kufizimi, ndikimi të papërshtatshëm, shtytje, shtypje, kërcënimi për ndërhyrje, të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga çfarëdo sferë çoftë."¹¹

vetëm në çfarëdo forme është që gjykata të fyhet, ose anëtarët e asaj gjykate, një dënim i përshtatshëm, në parim nuk do të përfaqësonte shkelje të Nenit 10 § 2 të Konventës." *Id.*

⁶ Shih nenet 20-37 të KEDNj para amandamentimit të Protokollit Nr. 11. Komisioni ishte funksional deri më 1 nëntor 1998, kur Protokollit Nr.11 hyri në fuqi.

⁷ Shih Aplikacionin Nr.19589/92, *B Company kundër Holandës*, paragrafi 60. Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 19 maj 1994.

⁸ Komisioni për të Drejtat e Njeriut, seanca e Gjashtëdhjetë, Pika 11 e agjendës së përkohshme: Të Drejtat Civile dhe Politike, përfshirë pyetjet lidhur me Pavarësinë e Gjyqësorit, Administrimi i Drejtësisë, Mosndëshkimi, Raporti i Raportuesit Special mbi pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve, Leandro Despouy. E/CN.4/2004/60, 31 dhjetor 2003.

⁹ E/CN.4/Sub.2/1985/18 dhe Add.1-6, para. 75. "Deklarata Singhvi" ishte përgatitur nga Z. L.V. Singhvi, Reporter Special i KB-ve në Pavarësinë e Gjyqësorit në vitin 1989. Reporterit Special ju kishte besuar përgatitja e një raporti mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit dhe pavarësinë e avokatëve nga ana e Nën-Komisionit të KB-ve për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave në vitin 1980. Vet Deklarata ndodhet në përmbajtjen e dokumentit E/CN.4/Sub.2/1985/18/Add.5/Rev.1.

¹⁰ UNGA Rezolutat 40/32 dhe 40/146. Parimet fillimisht ishin miratuar nga Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara për Parandalim të Krimin dhe Trajtimin e Kryesve të Veprave Penale, në Milano, gusht 1985.

¹¹ Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, e miratuar me 25 prill 2006, Rregullat Specifike të Etikës A1, 3(A.)

Monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur se siguria u ofrohet gjyqtarëve dhe/ose prokurorëve nga ana e policisë, vetëm në raste ku përfshihen të pandehur që mbahen në paraburgim dhe/ose gjatë gjykimeve që mbahen në salla të gjykimit në prezencë të audiencës publike. Në shumë raste, siç është e raportuar edhe më parë nga OSBE,¹² gjykimet mbahen në zyrat e gjyqtarëve. Veç kësaj, shumë nga këto raste kanë të bëjnë me të pandehur të cilët nuk gjinden në paraburgim. Andaj, shumë gjykime mbahen pa ndonjë sigurim të aranzhuar për gjyqtarë dhe prokurorë.

Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë llojet e incidenteve që kanë ndodhur në mungesë të aranzhimeve adekuate të sigurisë.

Me 16 dhjetor 2009, gjatë rrjedhës së një gjykimi të mbajtur në zyrën e një gjyqtari në gjykatën komunale në Prishtinë/Priština, i pandehuri fyeu gjyqtarin e rastit, në një mënyrë shumë ofenduese dhe vulgare dhe më pas e shtyu atë poshtë nga karrigia. Procesmbajtësi intervenoi dhe e nxori të pandehurin jashtë zyrës. Kur gjyqtari doli në korridor për ta informuar policinë, i pandehuri, i cili po e priste atë, e shqelmoi fortë në stomak duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore. Me 23 dhjetor 2009 u ngrit një propozim akuzë kundër sulmuesit.

Me 18 nëntor 2009, në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane, një i pandehur u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes në tentativë. Pasi që u shpall aktgjykimi, i pandehuri ofendoi prokurorinë dhe e kërcënoi atë që “menjëherë pasi që [ai] të del jashtë, [ai] to ta presë [atë] në copa”. Procedura penale është filluar ndaj të pandehurit dhe ai u shpall fajtor për kërcënim ndaj personit zyrtar.

Me 18 shkurt 2009, para fillimit të një gjykimi pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë/Priština ku përfshiheshin dy të pandehur të ngarkuar me akuza për vrasje të rëndë dhe vrasje të rëndë në tentativë, kryetari i trupi gjykues iu drejtua anëtarëve të familjeve të të pandehurve, të cilët ishin pjesëmarrës në audiencë, që të ndalojnë së thirruri atë në telefon dhe së dërguari letra kërcënuese përmes postës. Ajo u a tërhoqi atyre vërejtjen se kryetari i gjykatës dhe prokurori publik janë të njoftuar për këto veprime kërcënuese.

Me 13 gusht 2009, një person i dënuar, derisa ishte në pushim tre-ditor nga burgu ku po vuante dënimin për kryerje të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, shkoi në objektin e gjykatës komunale në Vushtri/Vuçitrn (lokacioni aktual i prokurorisë publike së qarkut të Mitrovicë/Mitrovica). Atje, takoi prokurorin publik i cili trajtoi rastin e tij dhe në një mënyrë kërcënuese iu drejtua atij me fjalët “Prokuror, kam ardhur me të pa edhe po e shoh qe je mirë, po s’ke me qenë gjatë”. Një propozim akuzë për kërcënim është ngritur kundër personit për kërcënim. Pas shqyrtimit kryesor, i pandehuri u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale se kërcënim dhe u dënua me tri muaj burgim.

Me 7 tetor 2009, në fillim të seancës gjyqësore para gjykatës së qarkut në Gjilan/Gnjilane, prokurori publik, gjersa lexonte ndryshimet ne aktakuze u

¹² Shqyrtimi i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale: *Administrimi i Drejtësisë në Gjykatat Komunale*” (mars 2004), faqe 26; Raporti i OSBE-së mbi *Administrimin e Drejtësisë* (mars 2002), faqe 19.

sulmua nga i pandehuri, fillimisht i akuzuar për vrasje të rënd dhe tentim vrasje të rënd. Kur prokurori iu drejtua çështjes së ndjeshme se kush e kishte therur viktimën, i pandehuri i cili qe ulur jo larg tij, rrëmbeu karrigen dhe e gjuajti me të drejtim të tij. Si rezultat, prokurori vuajti lëndime trupore. Me 26 janar 2010, i pandehuri u shpall fajtor për sulmin ndaj personin zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe u dënua me gjashtë muaj burgim.

Me 15 janar 2009, në prokurorinë publike të qarkut në Mitrovicë/Mitrovica (aktualisht e vendosur në objektin e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn), një palë e një rasti të gjykatës hyri në zyrë të prokurorit publik dhe në prani të punonjësve të tjerë të prokurorisë, në mënyrë të frikshme, e kërcënoi atë me fjalët: “[...] Po ta jep fjalën që fëmijët e tu do të mbesin jetimë [...]”. Me 17 janar 2009, rasti u paraqit në polici. I pandehuri u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të kërcënimit dhe u dënua me pese muaj burgim.

Nëse pritet që “[g]jyqtari do të veprojë çdo herë në atë mënyrë që të promovojë besimin e publikut në dinjitetin, integritetin e pavarësinë e gjyqësorit”, siç kërkohet me Kodin e Etikës,¹³ gjyqtarëve do të duhet t’u ofrohen të gjitha kushtet për të i mundësuar atyre që në mënyrë të duhur t’i përmbushin detyrat e veta.

Pabarazia e vazhdueshme e trajtimit ndërmjet gjyqësorit dhe institucioneve nga degët e legjislativit dhe ekzekutivit sa i përket pagave, mjeteve logjistike dhe sigurisë personale, shpesh diskutohet. Viteve të kaluara, gjatë tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga OSBE, gjyqtarët dhe prokurorët janë ankuar për presionin e përhershëm që ju bëhet atyre nga komuniteti ndërkombëtar dhe për vëmendjen publike që marrin, dhe prapë, në të njëjtën kohë, për mungesën e vëmendjes me të cilën institucionet publike kanë trajtuar *inter alia*, kërkesat e tyre lidhur me sigurinë personale.

Duke i mohuar gjyqësorit konsideratë të duhur dhe të përshtatshme lidhur me sigurinë e tij, jo vetëm që edhe më tej thëllon hendekun ndërmjet degëve të pushtetit të gjyqësorit, ekzekutivit dhe legjislativit por edhe e zbeh besimin të cilin publiku i cili kërkon drejtësi ka në gjyqësorin.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) është etniteti përgjegjës për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor. Andaj, i përket KGjK-së që të mbrojë punën e pavarur të gjykatave dhe, pa dyshim, pavarësinë e gjyqtarëve dhe autonominë e prokurorëve. Aktualisht, rojet e sigurisë në hyrjet e gjykatave janë forma e vetme e sigurisë së garantuar për gjyqtarë dhe prokurorë nga ana e KGjK-së, madje edhe atëherë kur janë të domosdoshme aranzhime më të mëdha për shkak të rreziqeve të sinjalizuara apo të shfaqura për siguri. OSBE konsideron se çështja e sigurisë për anëtarët vendor të gjyqësorit duhet të merret parasysh në mënyrë serioze dhe të trajtohen si duhet nga ana e KGjK-së, mbi baza të secilit rast veç e veç.

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka pasur një Komision për Vlerësim të Kërcënimeve, i cili në mënyrë individuale vlerësonte kërcënimet ose kërcënimet e perceptuara kundër anëtarëve të gjyqësorit dhe prokurorisë. Nëse komisioni vlerësonte se një rrezik i mjaftueshëm

¹³ Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtarë, e miratuar me 25 prill 2006.

ekziston, gjyqtarit ose prokurorit i caktuohet mbrojtje e afërt. Megjithatë, kjo ishte e zbatueshme vetëm për personelin ndërkombëtar. E vetmja mundësi për gjyqtarët dhe prokurorët vendor ka qenë që ta informojnë policinë e Kosovës lidhur me shqetësimet e tyre, gjë që vërtetë nuk rezultoi në një mbrojtje të nivelit më të lartë. EULEX-i ka në shfrytëzim një mekanizëm të ngjashëm për të vendosur nivelin e kërcënimeve ndaj ndonjërit prej gjyqtarëve ose prokurorëve të vet ndërkombëtar dhe një njësi për mbrojtje të afërt që ofron siguri për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, kur kjo është e nevojshme.¹⁴

OSBE-ja ka monitoruar raste kur gjyqtarët dhe prokurorët vendor transferuan rastet tek kolegët e tyre në EULEX për shkak të shqetësimeve lidhur me siguri. Një praktikë e tillë nuk është mënyra më e mirë për të trajtuar çështjen, por me sa duket është e vetmja e përdorur deri më tani.

Në një rast të iniciuar nga Zyra e Prokurorit Special të Kosovës, me 23 korrik 2007, pesë të dyshuar ishin akuzuar për tentim, në dy raste të ndara, vrasje të një figure politike të profilit të lartë. Në një seancë të shqyrtimit kryesor me 8 tetor 2008 pranë një trupi gjykues vendor të gjykatës së qarkut në Prishtinë/Priština, një nga të pandehurit drejtoi kërcënime serioze te kolegji duke thënë se “[...] ai do të vë në zjarr çdo gjë dhe se ata [trupi gjykues] do të kuptojnë se kush është ai”. Anëtarët e kolegjit gjithashtu morën letra kërcënuese. Kryetari i trupit gjykues, për arsye sigurie, kërkoi me 11 qershor 2009 që rasti t’i transferohet gjyqtarëve të EULEX-it. Me 6 tetor 2009, rasti iu transferua EULEX-it dhe procedura rifilloi pranë një kolegji prej tre anëtarëve (dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor). Me 20 nëntor 2009, të pandehurit u shpallën fajtorë.

Në një shënim lidhur me këtë, në një rast që përfshinte figura politike të profilit të lartë, një gjyqtar vendor publikoi për mediat mendimin e tij kundërshtues i cili ishte prezantuar gjatë këshillimeve dhe votimeve të fshehta.¹⁵ EULEX-i ka raportuar se “[...] nuk duket se gjyqësori ka mbrojtje të mjaftueshme nga ndërhyrjet e jashtme. [G]jyqtarët e Kosovës punojnë në rrethana të vështira ku bëhen kërcënime dhe ushtohen presione.”¹⁶ EULEX-i theksoi se KGJK-ës duhet që të forcojë angazhimin e tyre që të sigurojnë se gjyqtarët dhe prokurorët punojnë në një mjedis të liruar nga çfarëdo lloj kërcënimesh, presionesh apo premtimesh.

OSBE-ja po ashtu ka monitoruar raste kur personeli ndihmës administrativ i gjykatave ishin shënjestër të fyerjeve, kërcënimeve dhe sulmeve nga individë të përfshirë në raste gjyqësore.

Me 7 maj, në objektin e gjykatës komunale në Prizren, dy persona fyen, kërcënuan dhe përdorën dhunë fizike ndaj një nëpunësi në gjykatë, duke i shkaktuar atij lëndime të rënda trupore. Ata gjithashtu sulmuan fizikisht një punonjëse të sigurimit, duke i shkaktuar asaj lëndime të lehta trupore. Një procedurë penale ishte iniciuar kundër sulmuesve dhe me 9 qershor 2009,

¹⁴ Njësit për Mbrojtje të Afërt i EULEX-it funksionon brenda Zyrës së Sigurimit të Misionit të EULEX-it.

¹⁵ Neni 122, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale në Kosovë, e 6 korrikut 2003. Kodi ishte plotësuar dhe ndryshuar më 27 nëntor 2008.

¹⁶ Deklarata për shtyp e EULEX-it – *Këshillimet dhe votimet janë konfidenciale*, 06 tetor 2009.

gjykata komunale në Rahovec/Orahovac shpalli të pandehurit fajtor dhe i dënoi ata më tre muaj burgim.

Me 30 dhjetor 2008 një gjykim për dhunim që përfshinte katër të pandehur filloi pranë gjykatës së qarku në Prishtinë/Priština. Në fund të seancës, pasi që trupi gjykues doli nga salla e gjykimit, dy nga të pandehurit kërcënuan se do ta djegin gjykatën dhe e shtynë për tokë njërin nga policët e sigurimit. Në ndërkohë, të pandehurit tjerë e goditën policin. Ndërkohë që situata në sallë të gjykimit doli nga kontrolli, anëtarët e familjes nga publiku ndërhyjnë dhe qetësuan të pandehurit derisa përforcimet e policisë hynë në sallë dhe prangosën të pandehurit.

Përfundim

Pavarësia nga këndvështrimi funksional nënkupton mos-ndërhyrje të organeve tjera jo-gjyqësore në kryerjen e funksioneve gjyqësore. Gjithashtu obligon institucionet që të mbrojnë punën e pavarur të gjykatave dhe, padyshim, pavarësinë personale të gjyqtarëve.

Siç është theksuar më lartë, gjyqtarët dhe prokurorët duhen të jenë të lirë për të marr vendime pa frikë për dëme fizike ndaj tyre ose anëtarëve të familjeve të tyre. Autoriteti dhe besueshmëria e zyrove të gjyqësorit dhe prokurorisë rrjedh nga dhe është e ndërtuar mbi integritetin personal dhe profesional të zyrtarëve që me ligj kanë mandatin e ndarjes së drejtësisë. Kërcënimet dhe sulmet e regjistruara kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve qëllojnë jo vetëm ata individualisht, ose institucionin gjyqësor që ata përfaqësojnë, por edhe thelbin e sistemit gjyqësor si një tërësi.

OSBE konsideron se, në qoftë se pritet që të përmbushen standardet e pavarësisë dhe paanshmërisë, anëtarët vendor të gjyqësorit duhet të trajtohen në pikëmbështetje të barabartë me zyrtarët në degët e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ. Gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor nuk u ofrohet mbështetja e duhur për t'u zhvilluar në një qendër profesionistësh të respektuar dhe të kualifikuar lartë. Nën këto rrethana, çfarëdo përpjekje për ndërtim kapacitetesh seriozisht dobësohet dhe nuk mund të arrijë qëllimet në mënyrën e duhur.

Rekomandime:

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- Që të marr parasysh themelimin e një komisioni për të trajtuar shqetësimet lidhur me siguri të ngritura nga gjyqtarët dhe prokurorët.
- Të sigurojnë në mënyrë adekuate pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit të Kosovës duke siguruar mbrojtje adekuate për gjyqtarët dhe prokurorët.